# UNIMARC SMALTO MURALE LUCIDO

FINITURË E HOLLUESHME ME UJË, PA AROMË, ME SHKËLQIM, V.O.C. I ULËT PËR SIPËRFAQJE TË MEDHA, AMBIENTE PUBLIKE DHE LOKALE NË SEKTORIN USHQIMOR

**seri 336**

## PËRSHKRIMI

UNIMARC SMALTO MURALE LUCIDO është smalto uji për brenda dhe jashtë me bazë rezinë akrilike. Pa aromë, pa formaldehid dhe VOC të ulët, specifik për trajtimin e sipërfaqeve të mëdha me standarde të larta higjieno-sanitare siç janë spitalet, shkollat, kopshtet, laboratorët mjekësore, ambientet në sektorin e ushqimit dhe mjediset e banimit.

UNIMARC SMALTO MURALE LUCIDO është formuluar për të garantuar:

-Depozitim të ulët të pluhurit

-Mbulim dhe zbardhje të lartë.

-Transpirim të mirë

-Rezistencë e shkëlqyer ndaj larjes, pastrimit dhe dezinfektimit.

-Shpejtësi në tharje duke reduktuar kohën për shtresën e dytë.

-Është në përputhje me kërkesat e Rregullores së KE-së 852/2004 përsa I përket pjesës së higjienes për produktet ushqimore.

## UDHËZIME PËR PËRDORIMIN

I aplikueshëm në:

-Suvatime të reja dhe të vjetra

-Sipërfaqe betoni.

-Sipërfaqe xhesi dhe kartonxhesi.

-Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale,të thara, kompakte,absorbuese dhe kohezive.

-Konglomeratë me natyrë të ndryshme përsa kohë që janë absorbues.

-Ideale për finiturë satine të veshjeve plastike për jashtë.

Sipërfaqet përgatiten sipas shpjegimit në paragrafin “Përgatitja e sipërfaqes”.

Mos aplikoni në sipërfaqe të freskëta. Dhe me tendencë alkaline, prisni një kohë të duhur maturimi, përgjithësisht prej 4 javësh.

-UNIMARC SMALTO MURALE LUCIDO nuk është I përshtatshëm për lyerjen e vazove ose ambalazheve të substancave ushqimore likuide (ujë, birrë, verë, etj...).

## KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

-Forma e lidhësit: Kopolimer akrilik në dispersion ujor.

-Klasifikimi i cilësisë së Ajrit të Brendshëm: A+

-Klasifikimi UNI EN 13300:

.Rezistenca ndaj larjes ISO 11998: klasi 1

.Shkëlqimi EN ISO 2813: >60, shkëlqim

-Mbulimi ISO 6504-3: klasi 2 me rreze prej 7 $m^2$/lt

**Karakteristika të mëtejshme:**

-Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,25±0,05 kg/l

-Reaksioni ndaj zjarrit EN 13501-1: klasi A2 S1 d0. Referuar një konsumi jo më të lartë se ai i përcaktuar dhe aplikimi në sipërfaqe me jo shumë lëndë të djegshme.

-Rezistenca ndaj larjes UNI 10560: >5000 cikle, e shkëlqyer- rezistente edhe ndaj 10000 cikleve.

-Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 30 minutash; shtresa tjetër pas 2 orësh.

Përputhet me HACCP sipas kërkesave të Reg 852/2004

*Raporti I provës N.3001F2015 Studio ASA - Treviso, sipas normës UNI 11021

*-Ruajtja e ndotjes UNI 10792: ΔL=0,4 shumë e ulët.

*-Fuqia mbuluese UNI ISO 6504-1: 99,8%

*-Lëshim arome UNI 11021:2002-Append. A: 1

*-Rezistenca ndaj larjes UNI 10560: >5000 cikle, e shkëlqyer

*-Rezistenca ndaj agjentëve të veçantë të larjes UNI EN ISO 2812-1: e pandryshueshme

-Raporti I provës N. 3004F2015 Studio ASA - Treviso:

-Përcaktimi i komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC) ISO 11890-2:2013: <0,01 g/l

-Përcaktimi i formaldehidit të lirë EPA 8315A:1996: <1 mg/kg

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe tërësisht e maturuar. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.

-Në prani të mykut trajtojeni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe

Fradi shpk

me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes). Për të mbrojtur murin nga formimi I mykut,

shtojini produktit higjienizuesin COMBAT 111 kod. 4810111 për aplikime jashtë ose COMBAT 444 kod. 4810444 për aplikime të brendshme.
-Hiqni,me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun prezent dhe pluhurat e bojës së vjetër. Eliminoni shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose bojës transpirante/tempera.
-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim.

### Sipërfaqet në suva, xhes dhe kartonxhes:
-Në sipërfaqet e brendshme niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni çarjet, plasaritjet dhe uljet me TAMSTUCCO 9400006/9410110; niveloni çarjet dhe stukimet me letër zmerile.
-Ngjisni çarjet me ngjitës adekuat.
-Kryeni ndonjë zbutje në suva me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose me RASOMARC 9500150 në bazë të llojit të sipërfaqes.
-Në sipërfaqe të pastruara dhe të thara aplikoni:
-Në sipërfaqet e brendshme një shtresë astar akrilik me bazë uji IDROFIS 4700006 ose astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.
-Në kartonxhes aplikoni astarin specifik që pigmentoset PREPARA 4710019.
-Në sipërfaqet e jashtme ose të brendshme, në prani të një trashësie të ulët të temperave të vjetra ose bojrave të pluhurosura, aplikoni një shtresë astari me solvent ISOMARC 4410111 ose astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.
-Për të realizuar sipërfaqe lisho mbi sipërfaqe poroze dhe pak uniforme, këshillohet të aplikohen 2 shtresa UNIMARC FONDO UNIVERSALE seri 335.
-Vazhdoni me aplikimin e Unimarc Smalto Murale Lucido.

**Sipërfaqe betoni:**
-Hiqni pjesët e betonit jo mirë të aderuara.
-Shufrat metalike të armaturës në sipërfaqe duhet të lyhen me BETOXAN PRIMER 9490125 Boiacca passivante.
-Rivendosni pjesët që mungojnë me zbutësin BETOXAN 400 ose BETOXAN 300 llaç tiksotropik anti-tkurrje me fibra të përforcuara 9490140/130; kryeni ngjitjen përfundimtare me anti-karbonatizuesin anti-tkurrje BETOXAN 200 9.490.120.

**Në sipërfaqe të pastruara dhe të thara aplikoni:**
-Në sipërfaqet e brendshme një shtresë astar akrilik me bazë uji IDROFIS 4700006 ose astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.
-Në sipërfaqet e jashtme ose të brendshme, në prani të një trashësie të ulët të temperave të vjetra ose bojrave të pluhurosura, një shtresë astari me solvent ISOMARC 4410111 ose astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.
-Për të realizuar sipërfaqe lisho mbi sipërfaqe poroze dhe pak uniforme, këshillohet të aplikohen 2 shtresa UNIMARC FONDO UNIVERSALE seri 335.
-Vazhdoni me aplikimin e UNIMARC SMALTO MURALE LUCIDO.

* (Hollimi I astarit dhe sasia për t'u aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqe specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).

## UDHËZIME PËR APLIKIM
Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C
Lagështira relative e ambientit: <75%
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C
Lagështira e sipërfaqes: <10%
-Mjetet: penel, rrul, pistoletë dhe spraj.
-Hollimi: shtresa e parë me 10% ujë; 0-5% për shtresat pasardhëse.
-Në aplikimin me spraj (airless) hollimi (0-10%) varion në bazë të mjetit të përdorur dhe presionit të ushtruar.
-Për të përmirësuar karakteristikat e UNIMARC SMALTO MURALE LUCIDO është e nevojshme të përgatiten sipërfaqet, të sheshta dhe lisho.
-Mjetet duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me ujë.
-Shkalla e mbulimit: 9-10 $m^2$/lt për shtresë për sipërfaqet lisho dhe mesatarisht absorbuese. Është mirë që të përcaktohet shkalla e mbulimit me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

## NGJYROSJA

# UNIMARC SMALTO MURALE LUCIDO

FINITURË E HOLLUESHME ME UJË, PA AROMË, ME SHKËLQIM, V.O.C. I ULËT PËR SIPËRFAQJE TË MEDHA, AMBIENTE PUBLIKE DHE LOKALE NË SEKTORIN USHQIMOR

**seri 336**

Ngjyrosja mund të arrihet përmes sistemit Marcromie tintometrik. Produkti gjithashtu mund të ngjyroset me kolorantët COLORADO seri 548. Në rast të përdorimit të fabrikimeve të ndryshme është e këshillueshme të përzihen midis tyre produktet e ndryshme për të shmangur ndryshime në tonalitete.

## MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30° C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 ° C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

## UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/ 42/ EC)
Cat. A/a: bojë me shkëlqim për mure dhe tavane të brendshëm (shkëlqimi <25@60°) (bazë uji): 100 g/l (2010)
Cat. A/c: bojë për mure të jashme të sipërfaqeve minerale (bazë uji) : 40 g/l (2010)
UNIMARC SMALTO MURALE LUCIDO përmban max: 1 g/l VOC
Përdorni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit, mos I hidhni ambalazhet në ambient, lini të thahen mbetjet dhe I trajtoni ato si të veçanta. Mbajini larg përdorimit nga fëmijët. Në rast të gëlltitjes konsultohuni menjëherë me mjekun dhe I tregoni ambalazhin ose etiketën. Mos i hidhni mbeturinat në kanalizime, korsitë e ujit dhe në terren.  Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

## SPECIFIKIMET

Smalto I hollueshëm me ujë, me shkëlqim për sipërfaqe të mëdha. Aplikimi, në sipërfaqe të parapërgatitura për UNIMARC SMALTO MURALE LUCIDO seri 336, të hollueshëm me ujë, pa aromë, me bazë rezinë akrilike në dispersion ujor, në të paktën 2 shtresa në sasinë e caktuar nga absorbimi I sipërfaqes.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € ................ per m².

*SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperienca e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.*

Eradi shpk